



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.265/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.265/2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 30.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ku pretendohet se në tubimin e Lëvizjes Vetëvendosje, të mbajtur në Komunën e Vushtrrisë, është publikuar një video në mediat elektronike, në të cilat vërehet prania e disa fëmijëve të mitur, nën moshën 15 vjeçare, pa prezencën dhe pëlqimin e prindërve. Më tutje në ankesë pretendohet se subjekti politik LVV se me këto veprime ka konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, siç përcaktohet me nenin 5. Par.3 të të Rregullores Zgjedhore 07/2024. Po ashtu në ankesë pretendohet se me përdorimin e fëmijëve të mitur nën moshën 15 vjeçare, janë cenuar rëndë dispozitat e lartcekura dhe gjithashtu ky veprim përbën edhe shkelje të drejtave të fëmijëve të përcaktuara me kushtetut dhe konventa ndërkombëtare pasi që fëmijët nuk mund të përdoren dhe shfrytëzohen për qëllime të organizimit të fushatës zgjedhore.

Kërkojnë nga PZAP, që të nxjerrë vendim të bazuar ankesën e tyre.

Si provë në ankesat kanë bashkangjitur CD me video inqizim dhe ftesën e publikuar nga Lëvizja Vetëvendosje lidhur me njoftimin për tubim.

PZAP me datë 31.01.2024 iu drejtua për përgjigje në ankesë subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Në përgjigjen e LVV-së, lidhur me pretendimet në Komunën e Vushtrrisë ku pretendohet se publikimi i një video në mediat elektronike, në të cilat vërehet prania e disa fëmijëve të mitur nën moshën 15 vjeqare, pa prezencën dhe rrjedhimisht, pa pëlqimin e prindërve në tubimin e Lëvizjes Vetëvendosje të mbajtur në Komunën e Vushtrrisë, kinse përbën shkeljen e dispozitave përkatëse të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2025, konkretisht nenit 5, paragrafit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, theksojnë se është i paqëndrueshëm sepse nga provat vërehet se nuk është e ndërlidhur me angazhimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në fushat, rrjedhimisht subjekti i tyre nuk ka angazhuar fëmijë në fushatë. Po ashtu në përgjigje theksohet se nga pretendimet e ankuesit se prezenca e fëmijëve të mitur vërehen se janë pa pëlqimin e prindërve të tyre, parashtruesi i ankesës nuk e ka argumentuar këtë fakt.

Kërkojnë nga PZAP-i, të merret vendim lidhur me refuzimin e kësaj ankese.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se subjekti politik në fjalë nuk ka bere shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, i cili përcakton se *“Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve. Mbi bazën e provave me saktësisht nga CD nuk mund të vërtetohet se fëmijët kane qene pa përcjelljen e prindërve, ndërsa nga linku i rrjetit social facebook i përfshirë në ankesë është i zbrazët dhe nuk mund të vërtetohet asnjë pretendim i parashtruesit të ankesës. Me shikim në provat e ofruara përkatësisht në CD e ofruara si prova me fëmijë shihen edhe persona madhor që mund të konsiderohen se kanë qenë prindërit e tyre. Ne anën tjetër neni 117 par. 3 LZP, kur vendos për ankesat PZAP bazohet në prova të qarta dhe bindëse. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në ankese.*

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.265/2025 datë 01.02.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.